



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.Akti 1447

Korçë në datë 15.06.2023

DEFTESE KOMUNIKIMI

DREJTUAR: Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane

Bashkangjitur shkreses po ju dergojme vendimin e Gjykes per fillimin e procedures se falimentit ne ceshtjen civile me pale:

Kerkues : Ministria e Financave dhe Ekonomisë me adresë : Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Person i trete : Shoqëria "Mika Korçë" sh.a., me NIPT: J64103104K, me adresë: Unaza e Qytetit, Korçë.

Me objekt : Për fillimin e procedurës së falimentimit.

Baza ligjore : Neni 9, 11, 13, 14, 17 të Ligjit nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin".

Kerkojme nga ana juaj te beni afishimin e ketij vendimi ne faqen zyrtare.

Shënim: Kjo dëftesë ju dërgohet në dy kopje, me qëllim që njëra shkresë e cila konfirmon marrjen dijeni nga ana juaj të kthehet përsëri në Gjykatë.

GJYQTARE
Eglantina MIKANI

Marrësi në dorëzim(emër,mbiemër,nënshkrimi)

Data e komunikimit _____

FTUESI/POSTA _____

1919
100
100



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

NR.REGJ.THEM.(1447)

Korçë, më dt.15.06.2023

V E N D I M

“Për fillimin e procedurës së falimentimit”

Sot më dt.15.06.2023, une gjyqtarja Eglantina Mikani, gjyqtare prane Gjykates te Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korce, pasi mora ne rishqyrtim ne dhome keshillimi aktet e ceshtjes civile regjistruar me nr.1447 e cila i perket :

Kerkues : **Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tirane** me adresë : Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Person i trete : **Shoqëria "Mika Korçë" sh.a.**, me NIPT: J64103104K, me adresë: Unaza e Qytetit, Korçë.

Me objekt : Për fillimin e procedurës së falimentimit.

Baza ligjore : Neni 9, 11, 13, 14, 17 të Ligjit nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin".

si dhe Aktin e Ekspertimit dt.25.05.2023 te hartuar nga eksperti kontabel z.Luan Muça (i licensuar si auditues ligjor/administrator falimenti),

V E R E J

Me kerkese drejtuar Gjykates te Rrethit Gjyqesor Korce, pala kerkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë si përfaqësuese e aksionarit shtet, në cilësinë e debitorit, Shoqërisë "Mika Korçë" sh.a., me NIPT J64103104K, me adresë : *Unaza e Qytetit, Korçë*, ka kërkuar në gjykatë çeljen e procedurës së falimentimit, duke vlerësuar se ndodhet ne kushtet e kerkuara nga nenit 14 i ligjit "Për falimentimin".

Nga aktet bashkengjitur kerkeses, rezulton se Shoqëria "Mika Korçë" sha. është një shoqëri tregtare me kapital të përbashkët, ku 37.98% e aksioneve, aktualisht zoterohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndersa 62.02% e aksioneve zotërohen nga kompania greke "*Leaf Tobacco A. Michailides Company S.A*". Selia e kesaj shoqërie është në Korçë, por veprimtaria e saj është zgjeruar edhe në qytete të tjera të Shqipërisë si: Fier, Shkodër, Elbasan, Berat, Kuçovë etj.

Referuar edhe shenimeve te pasqyruara ne ekstraktin historik te regjistrit tregtar per te dhenat e subjektit "Shoqeri aksionere", Shoqëria "Mika Korçë" sh.a., ka per objekt të veprimtarisë së saj : *grumbullimin e duhanit nga fermeret, përpunimin dhe eksportimin e duhanit; shfrytëzimin dhe rinovimin e aseteve ekzistuese si dhe ndërtimin e aseteve të reja përpunuese të duhanit; zbatimin e teknologjive të reja për përpunimin dhe fermentimin e duhanit; dhënien e ndihmës shkencore agronomike me teknologji në fushën e kultivimit të duhanit, fermereve privat; etj.* Shoqëria ushtron këtë aktivitet që nga viti 1996 dhe "Fermerët" e "Shoqëria" i kane rregulluar marrëdhëniet e tyre me anë kontrate. Sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve, duhani i grumbulluar duhet të paguhej brenda 60 diteve nga dita e marrë.

Per vitet e fundit shoqëria ka patur probleme në likuidimin e detyrimeve sidomos ndaj punonjësve dhe fermereve, për shkak të paaftësisë paguese. Keshtu ka rezultuar se, me fermeret e zonave duhanmbjellëse dhe me përfaqësues të kompanisë janë organizuar disa takime, me përfaqësues të ish-MZHETTS dhe me përfaqësues të ish Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Nderkohe qe, nga pala kerkuese behet me dije se Administratori dhe Ortaku Mazhoritar ka zhvilluar edhe takim me Konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë në Selanik, i cili i ka shpjeguar se, arsyeja e vonesës së likuidimit të detyrimeve është për shkak të një procesi gjyqësor me "Deutsche Bank" për mos shlyerje të një kredie prej 150,000,000 Euro. Në lidhje me këtë proces, Gjykata e atij vendi ka vendosur bllokimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme të kompanisë.

Nisur nga situata e vështirë dhe shqetësimet në rritje, për mos likuidimin e detyrimeve ndaj fermerëve dhe punonjësve të kompanisë, eshte thirrur disa herë mbledhja e Asamblesë së Aksionareve, për të diskutuar dhe për të gjetur zgjidhje. Por mosprezenca e Ortakut Mazhoritar në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, e ka vështirësuar situatën. Për këtë arsye bazuar në Nenin 140, te Ligjit Nr. 99001, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me shkresën Nr. 925/2, dt.26.04.2019, eshte thirrur mbledhja e Asamblesë për shpalljen e shoqërisë "Mika Korça", sh a, në likuidim. Por Aksionari Mazhoritar i shoqërisë, "Leaf Tabacco A. Michailides Company A.S", nuk eshte paraqitur në mbledhje.

Meqënëse nuk eshte arritur kuorumi në mbledhjen e parë, Aksionari Shtet, po sipas përcaktimeve të shkresës Nr.925/1, dt.18.04.2019, ne dt.20.05.2019, në orën 16.00`, eshte rimbledhur në sallën e mbledhjeve në ambientet e MFE-së, ndërsa Aksionari mazhoritar i shoqërisë, "Leaf Tabacco A. Michailides Company S.A", përsëri nuk eshte paraqitur në mbledhje. Për rrjedhoje, si rezultat i mungesës së kuorumit të përcaktuar në Nenin 144 të Ligjit Nr.9901, dt.14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nuk eshte miratuar shpallja në likuidim e shoqërisë.

Ka rezultuar se, gjatë kësaj periudhe, nga punonjës të shoqërisë ka patur informacion që në Tetor 2019, do të paraqitet në shoqëri ortaku mazhoritar, për ti dhënë zgjidhje problematikës së krijuar. Ne te tilla rrethana pala kerkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e aksionarit Shtet, me shkresën Nr.20088/1, dt.26.12.2019, adresuar Drejtuesve të shoqërisë "Mika Korçë" sh.a, ka njoftuar edhe njëherë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, në dt.02.12.2019, me rend dite shpalljen e shoqërisë në likuidim.

Në dt.02.12.2019, përfaqesuesi i Aksionarit Shtet, sipas përcaktimeve të shkresës Nr.20088/2, dt.02.12.2019, në orën 16.00', është mbledhur në ambientet e MFE-së, ndërsa Aksionari mazhoritar "Mika Korçë" sha., nuk u paraqit në mbledhje, veprim ky i cili rezultoi te ishte në përsëritje prej tij. Për rrjedhojë, si rezultat i mungesës së kuorumit të përcaktuar në nenin 144 të Ligjit Nr.99001, dt.14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nuk është miratuar shpallja në likuidim e shoqërisë.

Në vijim ka rezultuar se, situata në këtë shoqëri, ka agravuar kjo edhe për shkak të gjobave dhe penaltiteteve të llogaritura nga sistemi, në rastin e mos likuidimit të detyrimeve brenda afatit ligjor. Nderkohe që nga shqyrtimi i ekstraktit të QKB-së konstatohet edhe fakti tjetër se, që prej muajit Gusht të vitit 2018 shoqërisë i janë vendosur sekuestro konservative, për shkak të detyrimeve të prapambetura të palikuiduara.

Përveç sa sipër, edhe Përmbartësja Gjyqësore Valbona Qehajaj me shkresën Nr.59 dt.16.02.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si aksionar i paketës shtetërore në shoqërinë "Mika Korçë" sh.a, ka kërkuar prononcimin e saj, në lidhje me vazhdimin e procedurave për shitjen e pasurive të shoqërisë, me qëllim ekzekutimin e detyrimit prej 14,150,311 lekë, kundrejt kreditorit Qerime Ibro, për dëmin e shkaktuar nga aksidenti në punë, ku ka ndërruar jetë shtetasi Edmir Ibro. Lidhur me kete, Zyra Përmbartimore i është drejtuar edhe strukturave të Policisë së Shtetit për informacion mbi vendodhjen e Administratorit të shoqërisë "Mika Korçë", Spyridon Anthomclidis, nga ku ka rezultuar se ai nuk ndodhet në Shqipëri. Në këto kushte, si dhe duke qenë se pala debitorë është njoftuar me shpallje publike për veprimet përmbartimore (*nuk gjendet njeri në adresën e deklaruar në QKB, pasi nuk ushtrohet aktivitet*), i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë të caktojë një përfaqësues ligjor për debitorin shoqëria "Mika Korçë" sha. Rezultoi se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin Nr.1173, dt.10.09.2020, ka vendosur : *"Pranimin e kërkesës së Përmbartëses Gjyqësore dhe caktimin e Përfaqësuesit ligjor, Av.Dea Gjanci, anëtare e Dhomës së Avokatisë Korçë, për fazën e ekzekutimit të "Urdhrit të ekzekutimit"*.

Për sa sipër, por dhe në kushtet kur nga pala kerkuese bëhet me dije se, shoqëria kishte edhe shumë kreditorë të tjerë, me pretendimin se ndodhej në kushtet e përcaktuara në Nenin 16 të Ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin", ajo ka kërkuar shpalljen e shoqërisë në falimentim.

Bashkë me kërkesën nga pala kerkuese janë paraqitur aktet e cituara më poshtë : Ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëria "Mika Korçë"; Pasqyrat Financiare 2016; Pasqyra e Pozicionit Financiar 2016-2015; Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve 2016-2015; Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2016-2015; Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare 2016-2015; Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto 2016; Aktivitet afatgjatë material me vlerë fillestare 2016; Amortizimi i aktiveve afatgjatë material 2016; Vlera kontabël neto e aktiveve afatgjatë material 2016; Gjendja e bankave në datën 31.12.2016; Gjendja e Inventarit 31.12.2016 (Korçë, Elbasan, Berat); Llogaria 401/1, 401/2 2016; Lëvizjet e llogarive debitorë e kreditorë Tetor-Nëntor-Dhjetor 2016; Fatura të palikuiduara deri në datën 31.12.2016 (Llogaria 411); Kapniki 1997-2016, Efekte për t'u paguar (Llogaria 403); Rakordimi i llogarive 404/ A. Michailides (Fatura për furnizim materiale); Llogaria 467 Të tjerë debitorë e kreditorë (e konvertuar) 31.12.2016; Kartela e shlyerjes së detyrimit për subjektin qiramarrës ElitRCA; Pasqyrat Financiare 2017; Pasqyra e Pozicionit Financiar 2017-2016; Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve 2017; Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2017-2016; Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare 2017-2016; Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto 2017;

Aktivitet afatgjata material me vlerë fillestare 2017; Amortizimi i aktiveve afatgjata material 2017; Vlera kontabel neto e aktiveve afatgjata material 2017; Gjendja e bankave në dt.31.12.2017; Gjendja e Inventarit 31.12.2017(Korçë, Elbasan, Berat); Lëvizjet e llogarive debitore e kreditore Tetor-Nëntor-Dhjetor 2017; Fatura të palikuidura deri në dt.31.12.2017 (Llogaria 411); Kapniki 1997-2017, Efekte për t'u paguar (Llogaria 403); Rakordimi i llogarise 404/ A. Michailides (Fatura për furnizim materiale); Llogaria 467 Të tjerë debitore e kreditore (e konvertuar) 31.12.2017; Llogaria 401/1, 401 /2 2017; Pasqyrat Financiare 2018; Pasqyra e Pozicionit Financiar 2018-2017; Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve 2018-2017; Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse 2018-2017; Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare 2018-2017; Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto 2018; Shënimet shpjeguese; Aktivitet afatgjata material me vlerë fillestare 2018; Amortizimi i aktiveve afatgjata material 2018; Vlera kontabel neto e aktiveve afatgjata material 2018; Gjendja e Inventarit 31.12.2018(Korçë, Elbasan, Berat); Llogaria 401/1, 401/2 2018; Lëvizjet e llogarive debitore e kreditore Janar-Dhjetor 2018; Përmbledhëse e diferencave nga konvertimi 2018; Fatura të palikuiduara deri në datën 31.12.2018 (Llogaria 411); Kapniki 1997-2018, Efekte për t'u paguar (Llogaria 403); Rakordimi i llogarisë 404/ A. Michailides (Fatura për furnizim materiale); Llogaria 467 Te tjerë debitore e kreditore (e konvertuar) 31.12.2018; Llogaria 404/ Furnitorët e Greqisë, për Korçën dhe Beratin; Llogaria 411/ Klientët e Greqisë, për Korçën dhe Beratin; Llogaria e Mjeteve Kryesore si Toka, Ndërtesat, Mjete Transporti, Makineri-Pajisje, për Korçën dhe Beratin; Raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paafësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit (gjithsej 2 Fletë); Bilancin dhe pasqyrat financiare për 2019 (gjithsej 7 Fletë); Llogarite Furnitor/Kliente 2019 (gjithsej 30 Flete); Inventari I Mjeteve kryesore Ndertesa +Makineri 2019 (gjithsej 14 Flete); Persa i perket : iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar; (Gjithsej 40 fletë); d) Gjendja e mjeteve monetare 30.09.02019 (gjithsej 1 fletë); dh) Përmbledhëse e pagave të punonjësve dhe pagesat e fermereve, të papaguara.

Duke aplikuar parashikimet ligjore ne rastin konkret Gjykata verën se :

Neni 1 i Ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin", parashikon shprehimisht se : *“Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për të lehtësuar zgjidhjen dhe shlyerjen kolektive të detyrimeve të debitorit në një procedurë falimentimi. ”*

Ndersa ne nenin 2 te tij parashikohet qellimi i procedures se falimentit : *“Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave.”*

Ne nenin 3 pika 21 te Ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin", ligjivenezi ka përcaktuar edhe kuptimin e termit “paafësi paguese” sipas te cilit : *“.....21. "Paafësi paguese" është gjendja kur një debitor, pavarësisht nëse është person fizik ose juridik, nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij brenda afatit. Në rastin e një personi juridik, paafësia paguese është gjithashtu situata financiare, në të cilën tërësia e detyrimeve të debitorit tejkalon vlerën totale të pasurive të tij.”*

Neni 13 i po ketij ligji i titulluar “Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit” parashikon se :
“Fillimi i procedurës të falimentimit mund të kërkohet nga debitori ose kreditorët në formë të shkruar dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.”

Ndersa ne nenin 14 te tij te titulluar “Kerkesa e debitorit” percaktohet se : ”1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

- a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;
- b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;
- c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa kjo periudhë është;
- ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:
 - i) vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;
 - ii) vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;
 - iii) vendndodhjen e pasurive; dhe/ose
 - iv) të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe
 - v) nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;
- d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
- dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;
- e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;
- ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;
- f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur....”

Neni 17 i Ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin", i cili lidhet me shqyrtimin e kërkesës së debitorit parashikon se : ” 1. Nëse debitori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të ketij ligji. Në qoftë se, pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve, vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e procedurës”

Kurse neni 29 i Ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin", i titulluar “Vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit” parashikon se :

“1. Gjukata e falimentimit vendos për fillimin e një procedure falimentimi kur plotësohen kushtet e parashikuara në këtë ligj.

2. Vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit përmban:

- a) në rastin e një personi fizik, emrin, mbiemrin, atësinë, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit dhe vendbanimin e debitorit ose, në rastin e personit juridik, emrin, llojin e veprimtarisë, numrin e identifikimit të personit të tatueshëm dhe vendbanimin;
- b) caktimin e administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës në rastet kur gjykata e falimentimit vendos regjimin e specifikuar në pikën 1, të nenit 61, të ketij ligji. Vendimi përmban

emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal të identifikimit, numrin e licencës dhe adresën e administratorit të caktuar, duke treguar nëse është një administrator falimentimi ose një administrator mbikëqyrës;

c) urdhrin që siguron botimin e një kopjeje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Fletoren Zyrtare;

ç) kërkesën ndaj çdo personi ose subjekti që pretendon të jetë kreditor i debitorit, për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit ose administratorit mbikëqyrës brenda 45 ditëve nga publikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit; "

Ne perfundim, pas analizes se faktit, pretendimeve te pales kerkuese dhe analizes se parashikimeve ne ligj, gjykata veren se bazuar ne nenin 16 te K.Pr.Civile duhet te beje një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët ne proces.

Fillimisht Gjykata, konstatoi se ajo eshte paraqitur konform parashikimit te nenit 14 të ligjit Nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin" dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë referuar përcaktimeve te nenit 11 te ketij ligji ka kompetencen tokesore per shqyrtimin e saj persa qëndra kryesore ku ushtron aktivitetin e saj Shoqëria "Mika Korçë" sh.a. per te cilen kerkohet edhe shpallja e falimentimit, është në Korçë.

Procedura e falimentimit perfaqeson procesin e likujdimit te nje subjekti qe ndodhet ne kushtet e paaftesise paguese apo mbingarkeses se tij me borxhe. Kjo procedure ka per qellim likujdimin e subjektit, nese gjykohet se shitja e pasurive te tij, do te jete me perfitim per kreditorët ose krijimin e nje plani riorganizimi per kete subjekt, ne rast se arrihet ne perfundimin se nje veprim i tille eshte i mundur.

Fillimi, ne rruge gjyqesore, i procedures se falimentimit realizohet vetem ne kushtet e ekzistences se shkakut te falimentimit:

- a) gjendje e paaftesise paguese te subjektit qe i drejtohet kerkesa per falimentim; dhe/ose
- b) mbingarkeses se subjektit me borxhe

Legjitimitimin aktiv per fillimin e procedurave gjyqesore te falimentimit, e gezon kreditori, debitori si dhe organet tatimore, ne rast konstatimi te humbjeve ne bilanc te subjektit per nje periudhe fiskale te caktuar. Ne rastet kur, kerkesa per hapjen e procedurave te falimentimit paraqitet nga vete subjekti debitor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykates : listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku te shenohet vlere e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barre si i tille; listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat që përbejnë detyrimin përkatës ndaj tyre; një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë, etj.

Ne lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata ka arritur ne perfundimin se pala kerkuese legjitimohet te paraqese kete kerkese, pasi ka cilesine e debitorit ne proceduren e falimentimit dhe ndaj pasurisë së saj vleresohet se ka një interes me karakter pasuror.

Ne zbatim te parashikimeve te nenit 19/1 e 28 të ligjit 110/206 "Për falimentimin", ne kushtet kur nga nje rishikim i pergjithshem i dokumentacionit te sipercituar, gjykata vleresonte se, nuk mund te

konkludohej nese ndodhej ne kushtet kur vertetohej gjendja e paafesise paguese e debitorit per te deklaruar me pas edhe fillimin e procedures perkatese te falimentimit, ka konsideruar te domosdoshme qe paraprakisht te merrte mendimin e nje eksperti, per te vendosur me pas mbi fillimin ose jo te procedures se falimentimit. Dhe kjo me qellim, për të verifikuar nëse ekzistonin shkaqe për të filluar procedurën e falimentimit, për të verifikuar nëse pasuritë e debitorit mund të mbulonin kostot e procedurave të falimentimit, për të mbikëqyrur veprimtaritë e debitorit, por dhe për të dhënë një opinion nëse ishte e nevojshme të vendoseshin masa të përkohshme për të siguruar pasuritë.

Per kete qellim gjykata ka caktuar me cilesine e ekspertit, audituesin ligjor/administrator falimenti shtetasin Luan Myftar Muça (*respektivisht me nr.license 119 dt.26.12.2000 e nr.11 dt.15.10.2012, me NIPT K38708553S dhe nr.222 ne Regjistrin elektronik te eksperteve te Ministrise se Drejtesise*), te cilit iu caktuan detyrat e sipercituara.

Sipas Aktit te ekspertimit te hartuar ne Maj 2023, nga eksperti kontabel i emeruar eshte konstatuar nder te tjera se :

a). *Te drejtat e shoqerise (aktivet)* janë : “Aktivet monetare “(arka plus banka) 367,460 lek; “Inventare” 55,308,610 lek; “Aktive materjale” 107,464,427 lek; Pra ne total 163,140,497 lek, duke patur verejtje lidhur me te fundit pasi kane qendruar per nje kohe te gjate ne mangazine dhe duhet te kontrollohen nese ju ka rene cilesia dhe per me teper, vlera reale e tyre do te verifikohet nga eksperti vleresues si dhe vlerat qe do te nxjerrin ankandet;

b). *Detyrimet e shoqerise* jane : Detyrimet kundrejt fermerëve 129,968,568 lek; Detyrimi kundrejt punonjesve 30,683,724 lek; Detyrimi kundrejt Tatimeve 3,648,520 lek; Detyrimi kundrejt shtetasës Qerime Shefki Ibri 14,150,311 lek; Detyrimi kundrejt Shoqerise “Ecit” Sh.P.K 96,000 lek; Detyrimi kundrejt Subjektit “Ramiz Salla PF; Detyrimi kundrejt Petrit Noto 326,252 lek; Detyrimi kundrejt Shoqeria “Lybeshari” 1,562,534 lek; Detyrime te tjera kundrejt kreditoreve 2,033,401 lek; Pra, ne total 182,469,310 lek, duke konkluduar keshtu se, detyrimet e shoqerise jane me te medha se te drejtat per shumen 19,328,813 lek.

Gjithashtu nga eksperti, sipas ekstratit historik te kesaj Shoqerie eshte konstatuar edhe fakti tjetër se : ajo ka statusin pasiv qe prej dt.22.09.2022; Shoqeria nuk ka dorezuar bilancet e viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ndersa z.Nikolaos Kaltsidis i ka mbaruar mandati i administratorit te shoqerise ne dt.12.12.2017.

Per sa siper, eksperti ka konkluduar se :

- Shoqeria ka detyrime me te medha se te drejtat per shumen 19,328,813 leke; Detyrimet e shoqerise prej 182,469,310 leke rrjedhin para vitit 2017; Shoqeria ka nderprere aktivitetin qe prej vitit 2018; Mbeshtetur ne kerkesat e nenit 3 pika 21, neni 14 pika 1 e ligjit ekzistojne shkaqe per fillimin e procedures se falimentit;
- Pasurite e debitorit mbulojne koston e procedures se falimentit;
- Shoqeria nuk ka administrator, eshte e nevojshme qe te merren masa per te siguruar pasurine e debitorit;

Bazuar ne te dhenat e rezultuara nga aktet e paraqitura prej pales kerkuese dhe te shqyrtuara nga kjo gjykate por dhe ne konkluzionet e arritura nga eksperti, Gjykata çmon se kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “Mika Korçë” sh.a. është e bazuar ne prova e ne ligj e si e tille duhet te pranohet. Dhe kjo ne kushtet kur vertetohet ekzistenca e shkaqeve te fillimit te kesaj procedure siç jane mbingarkesa me borxhe dhe paafesia paguese ekzistuese e debitorit ne kete moment te shqyrtimit te kerkeses, persa provohet ekzistenca e detyrimeve te maturuara dhe te pa

paguara por dhe kreditorët kanë deshtuar në ekzekutimin e detyrimit në procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës të ekzekutimit vullnetar sipas parashikimeve të nenit 517 të K.Pr.Civile.

Në funksion të fillimit të kësaj procedure Gjykata çmon se duhet të caktojë si Administrator Falimentimi për debitorin Shoqëria "Mika Korçë" sh.a., z.Luan Mtyftar Muça me licencë nr.11 dt.15.10.2012, me NIPT K38708553S. Në caktimin e Administratorit të Falimentimit nga gjykata u mbajt parasysh fakti i konstatuar se, administratorit të emëruar të Shoqërisë z.Nikolaos Kaltsidis, i ka mbaruar mandati që në dt.12.12.2017 e nuk është kryer zgjatja e tij, por edhe fakti tjetër se Shoqëria ka ndërprerë aktivitetin e saj që prej vitit 2018. Nderkohe që ngelet në vlerësimin e administratorit të falimentimit marrja e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar pasurinë e debitorit/masën e falimentimit.

Përsa i përket Komitetit të Përkohshëm të Kreditorëve, të përcaktuar sipas shkronjës "dh" të 29 të Ligjit "Për Falimentimin", në kushtet kur nga debitori nuk është venë në dispozicion bashkelidhur kërkesës për shqyrtim lista e kreditorëve, çmohet se gjykata nuk mund të disponojë në këto momente procedurial me caktimin e tij.

Me fillimin e procedurës të falimentimit nga gjykata i kërkohej çdo personi ose subjekti që pretendon se është kreditor i debitorit për të paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit të falimentimit z.Luan Muça brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendren Kombëtare të Biznesit. Sikurse i kërkohej çdo personi fizik ose juridik i cili ka detyrime ndaj debitorit, Shoqërisë "Mika Korçë" sh.a. t'ia paguajë ato ndaj administratorit të falimentimit z.Luan Muça.

Nderkohe që referuar parashikimit të shkronjës "d" të pikës "2" të nenit 29 të ligjit nr. 110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin" në kushtet kur ligjvënasi ka përcaktuar se data në të cilën duhet të mbahet Mbledhja mbi Raportimin e kreditorëve caktohet jo më vonë se 120 ditë nga data e vendimit, patur parasysh momentin e dhenies së këtij të fundit, çmohet që të caktojë datën 28.09.2023 ora 11.00` si datë të Mbledhjes mbi Raportimin e kreditorëve të Shoqërisë "Mika Korçë" sh.a.

Se fundi për efekt të publikimit të këtij vendimi, por dhe në respektim të kërkesave të ligjit "Për falimentimin", e konkretisht nenit 29 pika "c", nenit 31 dhe 32 urdherohet :

- publikimi/botimi i një kopje të shkurtuar të vendimit në faqen zyrtare të : Gjykates të Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, të Qendres Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare;
- një kopje të përmbledhur të vendimit të komunikohet secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit edhe pse kreditorët dhe çdo palë tjetër e interesuar konsiderohen të njoftuar si pasojë e shpalljes publike;
- një kopje e vendimit për fillimin e procedurës së falimentimit të paraqitet në organin e regjistrimit i cili disponon regjistrin tregtar ku pala debitorë Shoqëria "Mika Korçë" sh.a. figuron e regjistruar;
- komunikimin e vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit, Zyres Qendrore të ASHK-së me qëllim njoftimin e të gjitha Drejtorive dhe Zyrave Vendore të saj për bërjen e shënimeve përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme për çdo pasuri të paluajtshme ku debitori është regjistruar si pronar si dhe për të gjitha të drejtat e tjera ligjore të debitorit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme;
- komunikimin e vendimit të fillimit të procedurës së falimentimit në të gjithë regjistrat e tjerë publikë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në regjistrin e barrëve siguroese dhe regjistrat e

autoriteteve të tjera publike që janë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi pasuritë që përbëjnë masën e falimentimit (prane te gjitha Bankave te nivelit te dyte, Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, Autoritetit Rrugor Kombetar etj.);

- nje kopje e vendimit per fillimin e procedures te falimentimit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. ti dergohet Qendres Kombetare te Biznesit dhe Qendres te Botimeve Zyrtare me qellim publikimin e shkurtimit te tij;

Bazuar ne nenin 31 te ligjin 110/2016 "Për falimentimin", per kryerjen e ketyre njoftime dhe shpallje publike nga gjykata cmohet qe te ngarkohet administratori i falimentimit z.Luan Muça. Persa i perket shpenzimeve ne lidhje me keto veprime procedurale i ngarkohen mases se falimentimit. Persa siper nje kopje e ketij vendimi t'i njoftohet administratorit te falimentimit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. z.Luan Muça.

PËR KËTO ARESYE

Bazuar ne nenin 306-310 te K.Pr.Civile, nenin 29 e vijues të ligjit nr.110/2016, dt.27.10.2016 "Për Falimentimin"

V E N D O S I

1. Pranimin e kerkeses se pales kerkuese, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tirane.
2. Fillimin ne dt.15.06.2023 te procedures se falimentimit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a., me veprimtari të saj : ” *grumbullimin e duhanit nga fermeret, përpunimin dhe eksportimin e duhanit; shfrytëzimin dhe rinovimin e aseteve ekzistuese si dhe ndërtimin e aseteve të reja përpunuese të duhanit; zbatimin e teknologjive të reja për përpunimin dhe fermentimin e duhanit; dhënie e ndihmës shkencore agronomike me teknologji në fushën e kultivimit të duhanit, fermereve privat; etj.*“ me NIPT J64103104K, me seli ne adresën : Unaza e Qytetit, Korçë, Shqiperi.
3. Caktimin si administrator te falimentimit per Shoqërine "Mika Korçë" sh.a., z.Luan Muça i dtl.18.09.1961, me nr.personal identifikimi G10918009M, mbajtes i licences me nr.11 dt.15.10.2012 (administrator falimentimi), me adrese : Tepelene, Lagjia "Demokracia" , tek ish Zyrtare e N.T.A dhe NIPT K38708553S.
4. Urdherohet publikimi/botimi i nje kopje te shkurtuar te vendimit ne faqen zyrtare te : Gjykates te Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Korce, te Qendres Kombetare te Biznesit dhe ne Fletoren Zyrtare.
5. T'i kerkoje cdo personi ose subjekti qe pretendon te jete kreditor i debitorit per te paraqitur pretendimet e tij ndaj administratorit te falimentimit z.Luan Muça brenda 45 diteve nga publikimi i vendimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.
6. Te caktoj daten 28.09.2023 ora 11.00` si date ne te cilen do te mbahet Mbledhja mbi Raportimin e kreditoreve te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a.
7. T'i kerkoje cdo personi fizik ose juridik i cili ka detyrime ndaj debitorit, Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. t'ia paguaje ato ndaj administratorit te falimentimit z.Luan Muça.

8. Administratori i falimentimit z.Luan Muça ti paraqese një kopje të përmbledhur të vendimit secilit prej kreditorëve të njohur të debitorit.

9. Administratori i falimentimit z.Luan Muça te paraqese menjehere një kopje të vendimit per fillimin e procedures se falimentimit ne organin e regjistrimit i cili disponon regjistrin tregtar ku pala debitore Shoqëria "Mika Korçë" sh.a.figuron e regjistruar.

10. Administratori i falimentimit z.Luan Muça ti komunikojë vendimin e fillimit te procedures se falimentimit, Zyres Qendrore te ASHK-se me qellim bërjen e shënimeve përkatëse ne regjistrat e pasurive të paluajtshme për çdo pasuri të paluajtshme ku debitori është regjistruar si pronar si dhe për të gjitha të drejtat e tjera ligjore të debitorit, të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

11. Administratori i falimentimit z.Luan Muça te komunikojë vendimin e fillimit te procedures se falimentimit në të gjithë regjistrat e tjerë publikë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në regjistrin e barrëve siguroese dhe regjistrat e autoriteteve të tjera publike që janë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive ose të të drejtave të tjera të debitorit mbi pasuritë që përbëjnë masën e falimentimit.

12. Nje kopje e vendimit per hapjen e procedurave te falimentimit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. t'i njoftohet : pales kerkuese Ministrise te Financave dhe Ekonomisë, Tirane si përfaqësuese e aksionarit shtet, në cilësinë e debitorit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a.; administratorit te falimentimit te kesaj shoqerie z.Luan Muça si dhe vete Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. (per kete te fundit nepermjet shpalljes publike).

13. Nje kopje e vendimit per fillimin e procedures te falimentimit te Shoqërise "Mika Korçë" sh.a. ti dergohet Qendres Kombetare te Biznesit dhe Qendres te Botimeve Zyrtare me qellim publikimin e shkurtimit te tij.

14. Shpenzimet gjyqesore te cilat perbehen nga tarifa mbi aktet, shpenzimet per ekspertin dhe shpenzimet per njoftimet, bazuar ne nenin 106 te Kodit te Procedures Civile, i ngarkohen pales kerkuese.

15. Kunder ketij vendimi pala kerkuese ka te drejte te beje ankim ne Gjykatën e Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem ne Tirane, brenda 15 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e njoftimit te arsyetuar te tij.

Korçë, sot më dt.15.06.2023.

GJYQTARE
Eglantina MIKANI

